



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# BULETINI I BILANCIT TË PAGESAVE

Zyra e Kryeekonomistit

Numër 9



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

**BULETINI I BILANCIT TË PAGESAVE**

**BOTUES** Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Zyra e Kryeekonomistit  
Garibaldi 33, Prishtinë  
Tel: ++381 38 222 243  
Fax: ++381 38 243 763

**Faqja e internetit** [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike** [statistics@bqk-kos.org](mailto:statistics@bqk-kos.org); [economicanalysis@bqk-kos.org](mailto:economicanalysis@bqk-kos.org)

**KRYEREDAKTOR** Gani GËRGURI

**REDAKTORË** Mentor GECI  
Valentin TOÇI

**Shtypur në:** "BLENDI", Prishtinë

Përdoruesit e të dhënave nga ky botim luten që të citojnë burimin.

Shtypur në 100 kopje.

**SHKURTESAT:**

|       |  |
|-------|--|
| ATP   | Agjensioni për Transferimin e Parasë                 |
| BE    | Bashkimi Evropian                                    |
| BEC   | Kategoritë e Gjëra Ekonomike                         |
| BP    | Bilanci i Pagesave                                   |
| BPM5  | Manuali i Bilancit të Pagesave (edicioni i pestë)    |
| BQE   | Banka Qendrore Evropiane                             |
| BQK   | Banka Qendrore e Republikës së Kosovës               |
| CEFTA | Marrëveshja Mbi Tregtinë e Lirë në Evropën Qendrore  |
| EJL   | Evropa Juglindore                                    |
| EULEX | Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit   |
| FMN   | Fondi Monetar Ndërkombëtar                           |
| IÇK   | Indeksi i Çmimeve të Konsumit                        |
| IHD   | Investimet e Huaja Direkte                           |
| KFOR  | Forca Ushtarake e NATO-së në Kosovë                  |
| NNEK  | Norma Nominale Efektive e Këmbimit                   |
| NREK  | Norma reale Efektive e Këmbimit                      |
| PBB   | Produkti i Brendshëm Bruto                           |
| pp    | Pikë Përqindje                                       |
| SRTN  | Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare |
| TKPK  | Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës             |
| UNMIK | Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë             |

**SIMBOLET KONVENCIONALE:**

|         |   |
|---------|---|
| " — "   | dukuria nuk ekziston                                |
| ". "    | dukuria ekziston, të dhënat nuk janë në dispozicion |
| " ... " | zero ose afër zeros                                 |
| (e)     | e vlerësuar   |
| (p)     | e projektuar  |
| (r)     | e reviduar  |

**INFORMATË:** Për një përshkrim më të detajizuar të terminologjisë, ju lutem që t'i referoheni shënimeve metodologjike.

**Lista e Tabelave:**

|   |    |
|---|----|
| Tabela 1. Llogaria rrjedhëse në vendet e EJL-së .....     | 2  |
| Tabela 2. Pasqyrë e bilancit të pagesave të Kosovës ..... | 5  |
| Tabela 3. Tregtia e mallrave .....                        | 7  |
| Tabela 4. Eksportet e Kosovës në BE dhe CEFTA .....       | 13 |
| Tabela 5. Importet e Kosovës nga BE dhe CEFTA .....       | 14 |

**Lista e Figurave:**

|  |    |
|--|----|
| Figura 1. Financimi i llogarisë rrjedhëse nga IHD-të .....                 | 6  |
| Figura 2. Pranimet dhe pagesat e llogarisë rrjedhëse .....                 | 7  |
| Figura 3. Indeksi NREK bazuar në IÇK.....                                  | 8  |
| Figura 4. Komponentët e NREK-ut bazuar në IÇK.....                         | 8  |
| Figura 5. Eksportet sipas kategorive të mallrave .....                     | 10 |
| Figura 6. Importet sipas kategorive të mallrave.....                       | 11 |
| Figura 7. Pjesëmarrja e kategorive të importit sipas klasifikimit BEC..... | 11 |
| Figura 8. Të ardhurat .....  | 15 |
| Figura 9. Bilanci i transfereve rrjedhëse .....                            | 16 |
| Figura 10. Dërgesat e emigrantëve .....                                    | 17 |
| Figura 11. Struktura e IHD-ve sipas sektorëve .....                        | 19 |

**Lista e Kutive:**

|   |    |
|---|----|
| Kutia 1. Lëvizja e normës reale efektive të këmbimit (NREK) bazuar në IÇK ..... | 8  |
| Kutia 2. Analiza e importeve sipas kategorive kryesore ekonomike.....           | 11 |
| Kutia 3. Metodologjia e llogaritjes së dërgesave të emigrantëve.....            | 16 |

# PËRMBAJTJA

|   |           |
|---|-----------|
| <b>1. Përmbledhje ekzekutive</b> -----                                  | <b>1</b>  |
| <b>2. Zhvillimet ekonomike në eurozonë dhe Evropën Juglindore</b> ----- | <b>2</b>  |
| <b>3. Zhvillimet makroekonomike në Kosovë</b> -----                     | <b>4</b>  |
| <b>4. Bilanci i Pagesave</b> -----                                      | <b>5</b>  |
| 4.1. Llogaria rrjedhëse -----   | 6         |
| 4.1.1. Mallrat dhe shërbimet -----                                      | 7         |
| 4.1.2. Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse-----                        | 14        |
| 4.2. Llogari kapitale dhe financiare-----                               | 17        |
| 4.2.1. Investimet e huaja direkte -----                                 | 18        |
| 4.2.2. Investimet në letra me vlerë dhe investimet e tjera -----        | 19        |
| <b>5. Shënime metodologjike</b> -----                                   | <b>21</b> |
| <b>6. Shtojca statistikore</b> -----                                    | <b>31</b> |

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Viti 2009 u karakterizua me shenjat e para të daljes nga recesioni në shumë vende të cilat ishin prekur nga kriza, përfshirë vendet e eurozonës dhe të Evropës Jug-Lindore (EJL). Disa nga vendet e eurozonës kishin shënuar rënie ekonomike të lartë – më të lartën që nga lufta e dytë botërore. Si rezultat i kësaj, bilanci tregtar i eurozonës u karakterizua me zvogëlim të shkëmbimeve tregtare. Zhvillimet që karakterizuan vendet e eurozonës u transmetuan edhe në vendet e EJL-së, duke shkaktuar kështu rënie të eksporteve dhe importeve, nivel më të ulët të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) si dhe rënie të dërgesave të emigrantëve.

Ngjashëm me vendet e rajonit, edhe ekonomia e Kosovës u karakterizua me nivel më të ulët të aktivitetit ekonomik, por norma e rritjes ekonomike vazhdoi të jetë pozitive. Si rezultat i krizës si dhe bllokadës tregtare nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, eksportet e Kosovës shënuan rënie. Në anën tjetër, importet për herë të parë që nga përfundimi i luftës shënuan rënie, edhe pse rënia ishte modeste. Ndikim në ngadalësimin e aktivitetit ekonomik në Kosovë ka pasur edhe ngadalësimi i kredihënies, pasi që bankat në Kosovë aplikuan politika më konzervative të kreditimit, posaçërisht për bizneset. Për më tepër, IHD-të shënuan rënie të konsiderueshme, ndërsa papunësia në rritje në vendet e zhvilluara ka pasur ndikim edhe në rënien e dërgesave të emigrantëve kosovarë.

Bilanci i pagesave të Kosovës në gjysmën e parë të vitit 2009 vazhdoi të karakterizohet me deficit të lartë në llogarinë rrjedhëse, i shkaktuar nga eksportet relativisht të ulëta krahasuar me importet. Mirëpo, në krahasim me periudhat paraprake, deficitin në llogarinë rrjedhëse shënoi rënie. Përpos zvogëlimit të importeve, ndikim në zbutjen e deficitit në llogarinë rrjedhëse ka pasur edhe rritja e suficitit në tregtinë e shërbimeve, ndërsa rënie e lehtë vërehet në kategorinë e të ardhurave si rezultat i rënies së kompensimit të punëtorëve. Rënie e konsiderueshme u shënuan edhe në transferet rrjedhëse, që kryesisht i atribuohet rënies së dërgesave të emigrantëve. Në anën tjetër, aspekt pozitiv mbetet suficiti në llogarinë kapitale e financiare që kryesisht buron nga IHD-të, përkundër rënies së konsiderueshme të tyre. Investimet në letra me vlerë u karakterizuan me një rënie, pasi që pasiguria në tregjet financiare ndërkombëtare bëri që këto investime të orientohen investime tjera, kryesisht në depozita, investime të cilat konsiderohet si më të sigurta.

Duke filluar që nga viti 2009, statistikat e bilancit të pagesave kanë filluar të përpilohen dhe publikohen për herë të parë në baza tremujore, respektivisht që nga ky edicion i Buletinit të Bilancit të Pagesave.

## 2. Zhvillimet ekonomike në eurozonë dhe Evropën Juglindore

Vendet e eurozonës po vazhdojnë të ballafaqohen me pasojat e krizës ekonomike që kaploi globin në vitin 2008. Megjithatë, që nga tremujori i tretë i vitit 2009, vendet e eurozonës zyrtarisht dolën nga recesioni duke raportuar një rritje të PBB-së prej 0.4 përqind. Përkundër shenjave të para të rikuperimit, jo të gjitha vendet e eurozonës raportuan rritje ekonomike. Nga kriza ekonomike globale u ndikuan edhe vendet e Evropës Juglindore (EJL). Si pasojë, vendet e EJL-së në përgjithësi shënuan rritje negative ekonomike. Shqipëria dhe Kosova janë vendet e vetme në rajonin e EJL-së të cilat, përkundër krizës, shënuan rritje pozitive ekonomike, megjithëse me normë më të ulët se në vitin e kaluar. Kriza ekonomike ndikoi në rënien e vëllimit të tregtisë, rënien e IHD-ve, tkurrjen e kredihënies dhe të dërgesave të emigrantëve, rrjedhimisht duke shkaktuar edhe rritje të papunësisë, ulje të kërkesës dhe rënie të çmimeve.

Kriza ka pasur ndikim edhe bilancin pagesave të vendeve të eurozonës. Kjo për arsye se ngadalësimi i theksuar i aktivitetit ekonomik në nivel global shkaktoi rënie të kërkesës së brendshme dhe asaj të jashtme. Rrjedhimisht, gjatë vitit 2008 dhe pjesës së parë të vitit 2009 u shënuar rënie e konsiderueshme në importet dhe eksportet e mallrave të këtyre vendeve. Megjithatë, në fund të tremujori të dytë të vitit 2009, në eurozonë për herë të parë që nga fillimi i krizës u paraqitën shenjat e përmirësimit të indikatorëve të ekonomisë. Ky përmirësim, në radhë të parë rezultoi nga suficiti tregtar i regjistruar në fund të tremujorit të dytë të vitit 2009. Në qershor 2009, për herë të parë që prej evoluimit të krizës, eksportet në eurozonë filluan të shënojnë rritje të lehtë dhe njëkohësisht i tejkaluan importet. Rritja e eksporteve rezultoi nga forcimi i kërkesës së jashtme dhe riaktivizimi i zinxhirit të ofertës ndërkombëtare. Në anën tjetër, mallrat e importuara në eurozonë vazhduan të bien, por me një ritëm më të ngadalësuar se sa gjatë vitit 2008. Llogaria e shërbimeve gjithashtu shënoi bilanc pozitiv, kurse, llogaria e të ardhurave shënoi rritje të deficitit. Ky zgjerim i deficitit të të ardhurave në vendet e eurozonës erdhi si pasojë e zvogëlimit të të ardhurave nga investimet. Si rezultat i zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve të këtyre vendeve drejt vendeve më pak të zhvilluara, në tremujorin e dytë u ngushtua edhe deficit i transfereve rrjedhëse, ndërsa IHD-të shënuan bilanc negativ. Mirëpo, investimet në letra me vlerë shënuan një ngritje mjaft të lartë të cilat kryesisht ishin investime në tregje financiare si dhe investime në bono të thesarit në eurozonë.

**Tabela 1. Llogaria rrjedhëse në vendet e EJL-së (kumulative brenda vitit kalendarik 2009)**

|                        | Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB-së) | Eksportet (ndryshimi vjetor, në %) | Importet (ndryshimi vjetor në %) |
|------------------------|--|------------------------------------|----------------------------------|
| Shqipëria              | -15.3                                      | -20.5                              | -6.5                             |
| Bosnja dhe Hercegovina | -11.3                                      | -23.4                              | -25.3                            |
| Kosova                 | -16.0                                      | -39.9                              | -1.6                             |
| Kroacia                | -6.0                                       | -18.9                              | -27.4                            |
| Mali i Zi              | -20.6                                      | -7.4                               | 25.6                             |
| Maqedonia              | -18.3                                      | -33.4                              | -23.4                            |
| Serbia                 | -2.5                                       | -32.4                              | -39.0                            |

Burimi: Komisioni Evropian; Bankat Qendrore të vendeve përkatëse.

Kriza globale u reflektua edhe në bilancin e pagesave të vendeve të EJL-së (Tabela 1). Në vendet e EJL-së kriza ndikoi në rënien e eksporteve, IHD-ve dhe dërgesave të emigrantëve. Deri në tremujorin e dytë të vitit 2009, Mali i Zi dhe Maqedonia janë dy vendet e EJL-së që shënuan deficitin më të lartë të llogarisë rrjedhëse në rajon me 20.6 përkatësisht, 18.3 përqind të PBB-së. Sidoqoftë, në fund të tremujorit të dytë filluan shenjat e para të zvogëlimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Zbutja e këtij deficiti në tremujorin e dytë erdhi si rezultat i rënies së kërkesës së brendshme për importe. Rënia më e lartë vjetore e importeve deri në qershor 2009 u shënuan në Serbi (39.0 përqind), pasuar nga Kroacia dhe Bosnja e Hercegovina (27.4 dhe 25.3 përqind). Përkundër efektit pozitiv që po tregon rënia e importeve për bilancin e llogarisë rrjedhëse në vendet e EJL-së, niveli i eksporteve në gjysmën e parë të vitit 2009 mbetet i ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Vendet që pësuan rënien vjetore më të theksuar të eksporteve paraqiten Kosova (39.9 përqind) dhe Maqedonia (33.9 përqind), pasuar nga Serbia me 32.5 përqind (Tabela 1). Në vendet e rajonit transferet rrjedhëse kryesisht karakterizohen me bilanc pozitiv. Sidoqoftë, në tremujorin e dytë të vitit 2009, dërgesat e emigrantëve si kategoria kryesore e transfereve rrjedhëse shënuan rënie prej rreth 8 përqind (mesatarja e rajonit).

IHD-të në EJL u karakterizuan më rënie të konsiderueshme në disa vende. Për shembull, IHD-të në Kroaci dhe Serbi, krahasuar me qershorin e vitit 2008, pësuan rënie vjetore prej 53.7 përkatësisht, 39.1 përqind. Rënie të lartë të IHD-ve kishte Bosnja e Hercegovina si dhe Maqedonia, ku rënia vjetore e IHD-ve deri në qershor 2009 ishte 27.5, respektivisht 62.7 përqind. Deri në qershor 2009 rritje të konsiderueshme vjetore të IHD-ve shënoi vetëm Shqipëria (119.3 përqind) ndërsa në Mal të Zi rritja ishte më modeste (1.1 përqind). Përveç IHD-ve, ishin edhe investimet në letra me vlerë të cilat shënuan rënie. Sa i përket asetëve rezervë, në Maqedoni dhe Bosnje e Hercegovinë ato shënuan rënie, ndërsa, si rezultat i tkurrjes së deficitit në llogarinë rrjedhëse asetet rezervë në Serbi shënuan rritje.

Asetet rezervë në Shqipëri gjithashtu u karakterizuan me rritje, si rezultat i nivelit të lartë të IHD-ve krahasuar me deficitin në llogarinë rrjedhëse.

### 3. Zhvillimet makroekonomike në Kosovë

Kriza ekonomike globale u reflektua edhe në ekonominë e Kosovës duke shkaktuar normë më të ulët të rritjes ekonomike e cila në vitin 2009 është projektuar të jetë rreth 3.8 përqind krahasuar me normën e rritjes prej 5.4 përqind në vitin 2008.<sup>1</sup> Efektet e krizës kryesisht u reflektuan në zvogëlimin e konsumit dhe investimeve të sektorit privat të cilat, në masën më të madhe, ishin pasojë e zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve, IHD-ve si dhe shtrëngimit të kredidhënies nga sektori bankar.

Dërgesat e emigrantëve, të cilat janë burim shumë i rëndësishëm i financimit për ekonominë e Kosovës, u ndikuan negativisht si pasojë e rritjes së normës së papunësisë në vendet ku janë të koncentruar emigrantët kosovarë, duke kufizuar kështu konsumin e ekonomive familjare. Si pasojë e krizës u ndikuan gjithashtu edhe investimet e sektorit privat. Kriza globale ndikoi negativisht mundësitë dhe planet investuese të shumë investitorëve të huaj potencial duke bërë që IHD-të në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 të shënojnë një rënie vjetore prej rreth 25 përqind. Për më tepër, kreditë e sektorit bankar, të cilat paraqesin një burim shumë të rëndësishëm për financimin e bizneseve në Kosovë, shënuan një normë më të ulët të rritjes që reflekton politikat kreditore më konzervative të ushtruara nga bankat komerciale. Kjo kryesisht për shkak të kujdesit të shtuar të bankave mbi performancën e ekonomisë së Kosovës gjatë këtij viti. Ngadalësimi të kredidhënies po ashtu mund t'i ketë kontribuar edhe norma më e ulët e rritjes së depozitave, që deri në një masë reflekton zvogëlimin e dërgesave të emigrantëve si dhe aftësinë më të dobët të ekonomisë në përgjithësi për të gjeneruar kursime.

Ekonomia e Kosovës vazhdon të mbetet një ndër ekonomitë e pakta në rajon që në vitin 2009 shënoi normë pozitive të rritjes, kryesisht rezultoi nga rritja e shpenzimeve publike të cilat në vitin 2009 shënuan një rritje vjetore prej rreth 20 përqind. Efekt pozitiv në normën e rritjes ekonomike ka pasur edhe norma më e ulët e rritjes së deficitit tregtar që, përkundër zvogëlimit të eksporteve, rezultoi nga rënia e lehtë e importeve. Rënia në nivelin e eksporteve dhe importeve pasqyron krizën ekonomike globale e cila ndikoi negativisht si kërkesën e jashtme ashtu edhe kërkesën e brendshme.

Recesioni që kaploi ekonominë globale kishte efekte në nivelin e çmimeve dhe ishte rrjedhojë e zvogëlimit të kërkesës së përgjithshme. Si rezultat i mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në

<sup>1</sup> Ndryshimet në PBB janë vlerësime të Fondit Monetar Ndërkombëtar të paraqitura në *IMF Concluding Statement, Shtator 2009*.

importe, niveli i çmimeve në vend ka treguar ndjeshmëri të lartë ndaj zhvillimeve globale duke u karakterizuar me deflacion gjatë pjesës më të madhe të vitit 2009. Shkaktari kryesor i deflacionit në ekonominë e Kosovës ishte rënia e çmimeve të produkteve ushqimore të cilat kanë pjesëmarrjen më të madhe në shportën e konsumit në Kosovë dhe paraqesin një ndër kategoritë e produkteve më të importuara në vend. Si rezultat, niveli i çmimeve në Kosovë u karakterizua me një rënie mesatare vjetore prej 2.4 përqind, rënie e cila krahasuar me vendet tjera të rajonit ishte më e theksuar. Si rrjedhojë e zhvillimeve të fundit ekonomike, gjatë vitit 2009 u shënua zhvlerësim i Normës Reale Efektive të Këmbimit (NREK) në vend, me implikime pozitive për konkurueshmërinë e produkteve kosovare në raport me produktet e vendeve partnere tregtare.

#### 4. Bilanci i Pagesave

Karakteristikë kryesore e bilancit të pagesave të Kosovës vazhdon të mbetet niveli i lartë i importeve, i cili shkakton një deficit të konsiderueshëm në llogarinë rrjedhëse (rreth 16 përqind të PBB-së, përfshirë asistencën e jashtme). Në krahasim me vitin e kaluar, deficitin e llogarisë rrjedhëse ka shënuar rënie si rezultat i deficitit më të ulët tregtar. Ndër faktorët më të rëndësishëm që zvogëlon deficitin e llogarisë rrjedhëse janë dërgesat e emigrantëve. Përveç dërgesave të emigrantëve, gjatë pjesës së parë të vitit 2009, rënia e lehtë e importeve po ashtu ka kontribuar që deficitin e llogarisë rrjedhëse të jetë më i ulët. Në anën tjetër, llogaria kapitale dhe financiare vazhdon të shënojë suficit, përkundër rënies së IHD-ve, ndërsa deri në qershor 2009 kishte normë pozitive të rritjes.


**Tabela 2. Pasqyrë e Bilancit të Pagesave të Kosovës, në milionë euro**

|  | 2004            | 2005            | 2006            | 2007            | 2008            | Qershor 2009* |
|--|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|-----------------|---------------|
| <b>1. LLOGARIA RRJEDHËSE</b>               | <b>-208.9</b>   | <b>-247.6</b>   | <b>-226.1</b>   | <b>-331.3</b>   | <b>-602.4</b>   | <b>-277.8</b> |
| <b>A. Mallrat dhe shërbimet</b>            | <b>-1,002.1</b> | <b>-1,087.0</b> | <b>-1,144.1</b> | <b>-1,316.7</b> | <b>-1,596.1</b> | <b>-700.3</b> |
| 1. Mallrat                                 | -983.1          | -1,078.5        | -1,173.1        | -1,368.0        | -1,668.2        | -763.0        |
| 2. Shërbimet                               | -19.0           | -8.5            | 29.0            | 51.4            | 72.1            | 62.7          |
| <b>B. Të ardhurat</b>                      | <b>138.3</b>    | <b>139.1</b>    | <b>158.8</b>    | <b>185.7</b>    | <b>155.5</b>    | <b>52.3</b>   |
| 1. Kompenzimi i punëtorëve                 | 142.3           | 145.2           | 146.5           | 154.3           | 166.6           | 79.7          |
| 2. Të ardhurat nga investimet              | -4.0            | -6.1            | 12.2            | 31.4            | -11.1           | -27.4         |
| <b>C. Transferet rrjedhëse</b>             | <b>654.9</b>    | <b>700.3</b>    | <b>759.2</b>    | <b>799.7</b>    | <b>838.2</b>    | <b>370.1</b>  |
| 1. Qeveria qendrore                        | 371.9           | 347.9           | 319.9           | 300.7           | 302.6           | 147.9         |
| 2. Sektorët tjerë                          | 283.0           | 352.4           | 439.3           | 499.0           | 535.6           | 222.3         |
| 2.1 Dërgesat e emigrantëve                 | 219.2           | 288.6           | 372.3           | 425.9           | 441.3           | 182.2         |
| <b>2. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE</b> | <b>76.9</b>     | <b>69.6</b>     | <b>-14.9</b>    | <b>91.3</b>     | <b>462.8</b>    | <b>243.0</b>  |
| <b>A. Llogaria kapitale</b>                | <b>19.3</b>     | <b>15.8</b>     | <b>20.8</b>     | <b>16.5</b>     | <b>10.4</b>     | <b>7.1</b>    |
| <b>B. Llogaria financiare</b>              | <b>57.6</b>     | <b>53.8</b>     | <b>-35.7</b>    | <b>74.8</b>     | <b>452.4</b>    | <b>235.9</b>  |
| 1. Investimet e huaja direkte              | 42.9            | 107.6           | 289.2           | 431.0           | 341.5           | 127.4         |
| 2. Investimet në letra me vlerë            | -32.1           | -17.5           | -65.4           | -36.6           | 16.8            | 27.2          |
| 3. Investimet tjera                        | -66.0           | -68.7           | -181.6          | -29.4           | 117.2           | 97.1          |
| 4. Asetet rezervë                          | 112.7           | 32.4            | -77.9           | -290.3          | -23.1           | -15.8         |
| <b>GABIMET DHE LËSHIMET NETO</b>           | <b>132.0</b>    | <b>178.1</b>    | <b>240.9</b>    | <b>240.0</b>    | <b>139.6</b>    | <b>34.8</b>   |

\*Të dhënat për vitin 2009 janë kumulative për periudhën Janar-Qershor.

Shkalla e mbulueshmërisë së deficitit të llogarisë rrjedhëse nga IHD-të ka shënuar rënie si rezultat i zvogëlimit të IHD-ve në dy vitet e fundit (Figura 1). Implikimet nga IHD-të më të ulëta mund të reflektohen në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik duke shkaktuar ngadalësim të rritjes ekonomike.

**Figura 1. Financimi i llogarisë rrjedhëse nga IHD-të, në përqindje**




\*Të dhënat për vitin 2009 janë kumulative për periudhë Janar-Qershor

#### 4.1. Llogaria rrjedhëse

Llogaria rrjedhëse deri në qershor 2009 u karakterizua me deficit prej 277.8 milionë euro. Deficiti në llogarinë rrjedhëse kryesisht vjen si rezultat i deficitit të lartë tregtar që reflekton varësinë e lartë të ekonomisë së Kosovës në mallrat e importuara. Megjithatë, në krahasim me vitin paraprak, deficitin në llogarinë rrjedhëse është zvogëluar për rreth 8 përqind, që kryesisht i atribuohet rënies së importit të mallrave. Me gjithë zvogëlimin, bilanci pozitiv i transeferëve rrjedhëse vazhdon të ketë efekt pozitiv në bilancin e llogarisë rrjedhëse. Deri në qershor 2009, suficit u regjistrua edhe në bilancin e shërbimeve dhe në kategorinë e të ardhurave. Kategoria kryesore në llogarinë rrjedhëse përfaqësohet nga transferet rrjedhëse (51.8 përqind e gjithsej të pranimeve në llogarinë rrjedhëse) ndërsa pagesat nga llogaria rrjedhëse në masën më të madhe janë të destinuara për blerjen e mallrave të cilat përfaqësojnë 78.6 përqind të gjithsej pagesave (Figura 2).

Figura 2. Pranimet dhe pagesat e llogarisë rrjedhëse, në përqindje



#### 4.1.1. Mallrat dhe shërbimet

Bilanci tregtar i Kosovës deri në qershor të vitit 2009 regjistroi deficit prej 778.1 milionë euro (Tabela 3). Ky deficit i atribuohet peshës së konsiderueshme të importeve, 93.1 përqind në gjithsej tregtinë e mallrave në Kosovë krahasuar me 6.9 përqind të eksporteve. Gjashtëmujori i parë i vitit 2009 karakterizohet me një rënie të ndjeshme të eksporteve në 62.7 milionë euro (104.4 milionë euro në qershor 2008). Norma nominale e rënies së eksporteve në Kosovë ishte 39.9%, e cila paraqet një normë të përafërt të rënies me vendet e tjera të rajonit.

Tabela 3. Tregtia e mallrave, në milionë euro (kumulative brenda vitit kalendarik)


|  | qershor 2006 | qershor 2007 | qershor 2008 | qershor 2009 |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| <b>Eksportet</b>                         | 48.3         | 74.9         | 104.4        | 62.7         |
| <b>Importet</b>                          | -554.6       | -697.0       | -854.9       | -840.8       |
| <b>Bilanci tregtar</b>                   | -506.3       | -622.1       | -750.5       | -778.1       |
| <b>Eksportet/Importet (në përqindje)</b> | 8.7          | 10.7         | 12.2         | 7.4          |

Ndërsa, si rezultat i deflacionit që ka qenë prezent në ekonominë e Kosovës që nga fillimi i vitit, norma reale e rënies së eksporteve për një masë ishte më e ulët se sa ajo nominale duke qëndruar në 37.5 përqind. Deflacioni në ekonominë e Kosovës gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 ndikoi në zhvlerësimin e NREK-ut, çka kontribuon pozitivisht në nivelin e konkurrueshmërisë së produkteve kosovare në raport me ato të vendeve tjera (Kutia 1).

**Kutia 1. Lëvizjet e Normës Reale Efektive të Këmbimit (NREK) bazuar në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK)**


Siç mund të shihet në Figurën 3, gjatë periudhës janar 2006–qershor 2009, NREK bazuar në IÇK mesatarisht u vlerësua për 2.0 përqind. NREK është vlerësuar si në raport me vendet e Bashkimit Evropian (1.6 përqind), e po ashtu me vendet e CEFTA-s, (1.9 përqind).

**Figura 3. Indeksi NREK bazuar në IÇK**



Vlerësimi i NREK gjatë periudhës janar 2006–qershor 2009 kryesisht ishte i nxitur nga inflacioni më i lartë në Kosovë, sidomos gjatë vitit 2008, përderisa efekti i Normës Nominale Efektive të Këmbimit (NNEK) ishte i një rëndësie dytësore pasi që NNEK e partnerëve tregtar ishte mjaft stabile gjatë kësaj periudhe (figura 4).

**Figura 4. Komponentët e NREK-ut bazuar në IÇK, janar 2006–qershor 2009**



Gjatë periudhës janar 2006–qershor 2009, NNEK e euros në Kosovë u vlerësua për një mesatare prej 0.8%, kurse mesatarja e normës së inflacionit në Kosovë ishte për 2.7pp më e lartë se sa

në partnerët e saj tregtarë. Për më tepër, këto trende të përgjithshme shënuan dallime të qarta në dinamikën e komponentëve të NREK-ut për grupe të ndryshme të vendeve. Vlerësimi i NREK-ut përkundrejt vendeve të BE-së ishte rezultat i normës më të lartë të inflacionit në Kosovë. Gjatë periudhës janar 2006–qershor 2009 mesatarja e normës së inflacionit në Kosovë kaloi mesataren e normës së inflacionit në vendet e BE-së për 3.1pp. Rëndësia e ndryshimeve në NNEK përkundrejt vendeve të BE-së është e parëndësishme sepse më tepër se  $\frac{3}{4}$  e shkëmbimeve tregtare me vendet e BE-së bëhet me ato vende të cilat përdorin euron. Vlerësimi i NREK-ut në relacion me vendet e CEFTA-së ishte i ndikuar nga norma më e lartë e inflacionit në Kosovë, si dhe nga lëvizjet në NNEK. Gjatë periudhës janar 2006–qershor 2009, mesatarja e normës së inflacionit në Kosovë ishte për 2.5pp më e lartë krahasuar me vendet e CEFTA-së, ndërsa NNEK e euros në Kosovë u vlerësua me një mesatare prej 0.8% kundrejt valutave të vendeve të CEFTA-s.


Mund të konstatohet se inflacioni shkaktoi vlerësimin e NREK në Kosovë dhe duke bërë produktet vendore më pak konkurruese në raport me produktet e vendeve partnere. Norma më e lartë e inflacionit në Kosovë krahasuar me partnerët e saj tregtar gjatë periudhës kohore janar 2006–qershor 2009 ishte e nxitur nga ndikimi direkt dhe indirekt i ngritjes së çmimit të ushqimit dhe energjisë në tregun botëror, produkte këto të cilat në shportën e konsumit në Kosovë kanë pjesëmarrje më të lartë krahasuar me partnerët tregtar. Vlerësimi i euros në Kosovë mund të ketë ndikuar në thellimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë vitit 2008, mirëpo zhvlerësimet e më vonshme mund të kenë ndikuar që produktet kosovare të jenë më të lira se sa ato të vendeve tjera. Duke pasur parasysh kufizimet e autoriteteve kosovare në ushtrimin e politikës monetare si pasojë e eurozimit, edhe politikat që do të mund të përdoren për të ndikuar në zhvlerësimin e NREK janë të kufizuara. Rrjedhimisht, politikat që do të kontribuonin në rritjen e produktivitetit në vend do të siguronin një rritje të qëndrueshme të konkurueshmërisë së produkteve vendore.

Sa i përket importeve, deri në qershor të vitit 2009, u shënuar një rënie vjetore prej 1.6 përqind në terma nominal. Kjo paraqet periudhën e vetme që nga paslufta në të cilën importi i mallrave në Kosovë shënoi rënie. Megjithatë, vlera reale e importeve ka shënuar ngritje për 2.4 përqind krahasuar me qershorin e vitit 2008. Ngadalësimi i theksuar i importeve krahasuar me vitin e kaluar reflekton ngadalësimin e aktivitetit të ekonomik dhe kërkesës së brendshme. Si rezultat i rënies më të theksuar në nivelin e eksporteve krahasuar me importet, mbulueshmëria e importeve me eksporte deri në qershor 2009 u zvogëluar në 7.4 përqind krahasuar me nivelin e mbulueshmërisë prej 12.2 përqind sa ishte deri në qershorin e vitit të kaluar. Në anën tjetër, struktura e importeve mbetet e ngjashme me periudhat paraprake sa i përket ndarjes sipas kategorive ekonomike (Kutia 2).

Rënia e eksporteve në Kosovë mund t'i atribuohet rënies së konsiderueshme të eksporteve të metaleve bazë. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur metalet bazë përbënin 64.8 përqind të gjithëj eksporteve, deri në qershor 2009, pjesëmarrja e kësaj kategorie ka rënë në 42.4 përqind (Figura 5). Që nga janari i vitit 2009, eksporti i metaleve bazë filloi të pësojë rënie drastike dhe deri në qershor 2009 norma vjetore e rënies së tyre arriti në 60.8 përqind. Kjo rënie reflekton rënien e kërkesës së jashtme dhe rënien e çmimeve për këto produkte. Produktet ushqimore, të cilat kanë pjesëmarrje prej 5.6 përqind në gjithëj eksportet, shënuan rënie të konsiderueshme (për 26.4 përqind)


krahasuar me qershorin e vitit 2008. Në anën tjetër, produktet minerale, që përbëjnë 14.7 përqind të gjithsej eksporteve, shënuan rritje vjetore prej 7.8 përqind. Rritje e konsiderueshme në pjesëmarrje të gjithsej eksporteve u shënuan në kategorinë e produkteve të plastikës dhe gomës, duke arritur në 12.3 përqind të gjithsej eksporteve. Kjo rritje është rezultat i prodhimit më të lartë të kompanive vendore.

**Figura 5. Eksportet sipas kategorive të mallrave, në përqindje**



Rënia e importeve në Kosovë deri në qershor 2009 kryesisht i atribuohet rënies së disa kategorive kryesore në strukturën e importeve, siç janë produktet minerale (Figura 6). Produktet minerale të cilat prej vitit 2006 përbëjnë kategorinë dominuese të importeve, në qershor 2009 zvogëluan pjesëmarrjen e tyre në 14.2 përqind të gjithsej importeve (20.9 përqind në qershor 2008). Rënia vjetore e importit të produkteve minerale ishte 33.3 përqind. Rënie vjetore regjistroi edhe importi i metaleve bazë (për 24.6 përqind) si dhe importi i produkteve ushqimore dhe pijeve (për 20.1 përqind). Ndërsa, dy kategoritë që shënuan rritje të importeve janë makinëritë e pajisjet dhe mjetet e transportit, të cilat krahasuar me qershorin e 2008 u rritën për 2.3, përkatësisht 4.2 përqind.


Figura 6. Importet sipas kategorive të mallrave, në përqindje



**Kutia 2. Analiza e importeve sipas kategorive kryesore ekonomike (Broad Economic Categories - BEC)**

Kategoritë Kryesore Ekonomike (BEC) paraqesin një klasifikim të agreguar të produkteve të importuara varësisht prej përdorimit final të tyre. BEC përpilohet sipas Klasifikimit Standard të Tregtisë së Jashtme (SITC) dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka filluar klasifikimin dhe përpilimin e të dhënave të tregtisë së jashtme në përputhshmëri me këtë standard prej vitit 2008. Sipas këtij standardi, produktet e importuara mund të ndahen në tri kategori të gjëra ekonomike si: mallra kapitale, mallra të ndërmjetme dhe mallra të konsumit.

Figura 7. Pjesëmarrja e kategorive të importit sipas klasifikimit BEC (kumulative brenda vitit kalendarik)



Struktura e mallrave të importuara sipas përdorimit final tregon se pjesa më e madhe e produkteve që importohen në Kosovë janë mallrat e ndërmjetme, me pjesëmarrje prej 41.7 përqind

(Figura 7). Vlera e mallrave të ndërmjetme të importuara deri në qershor 2009 është 350.3 milion euro që paraqet një rënie vjetore prej 2.8 përqind. Zvogëlimi i importit të këtyre mallrave kryesisht i atribuohet zvogëlimit të prodhimit të metaleve bazë dhe pajisjeve të procesuara industriale.

Mallrat konsumuese përbëjnë kategorinë e dytë më të madhe, me pjesëmarrje pre 30.9 përqind në gjithsej importet. Përqendrimi i lartë i këtyre mallrave në importe reflekton strukturën e ekonomisë së Kosovës e cila karakterizohet nga një shkallë e ulët të prodhimit vendor. Sipas të dhënave mbi mallrat e importuara, deri në qershor 2009, pjesëmarrja e mallrave konsumuese në gjithsej importet shënoi një rënie vjetore prej 0.5pp.

Importi i mallrave kapitale përbën kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët në strukturën e importeve të Kosovës (12.7 përqind). Pjesëmarrja e kësaj kategorie të importeve në gjysmën e parë të vitit 2009 shënoi një rritje vjetore prej 3.4pp. Në vlerë monetare, importi i mallrave kapitale gjatë kësaj periudhe ishte për 33.8 përqind më i lartë se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Përkundër nivelit ende të ulët, trendi rritës i kësaj kategorie në vitet e fundit paraqet një indikator të mirë për ekonominë e Kosovës duke reflektuar rritjen potenciale të prodhimit vendor.

Vendet e CEFTA-s dhe ato të BE-së përfaqësojnë partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës. Anëtarësimi i Kosovës në CEFTA hapi mundësinë për tregje potenciale për Kosovën, njëherit duke i shtuar presionet konkurruese për prodhuesit vendorë. Megjithatë, jo të gjitha vendet anëtare të CEFTA-s po e zbatojnë marrëveshjen në raport me Kosovën, si Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, të cilat për arsye politike pengojnë eksportin e produkteve Kosovare drejt këtyre vendeve duke mos e zbatuar objektivin kryesor të kësaj marrëveshje – qarkullimin e lirë të mallrave ndërmjet vendeve anëtare. Kosova gjithashtu ka marrëveshje për tregti të lirë me vendet e BE-së, marrëveshje kjo e cila përjashton rreth 95 përqind të produkteve nga tarifatat doganore. Po ashtu, Kosova ka nënshkruar marrëveshje për tregti të lirë me SHBA-të, e cila lehtëson eksportin e mallrave të Kosovës në këtë vend.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2009 ishte evident zvogëlimi i shkëmbimeve tregtare me partnerët kryesorë tregtarë të Kosovës (Tabela 4 dhe 5). Në qershor 2009, eksportet e Kosovës drejtë BE-së ishin ekuivalent me 42.9 përqind të gjithsej eksporteve (51.5 përqind në qershor 2008). Prej shteteve të BE-së, Italia absorboi pjesën më madhe të eksporteve të Kosovës me vlerë prej 18.5 milionë euro, kryesisht metale bazë dhe produkte minerale. Eksportet e mallrave në vendet e anëtare të CEFTA-s përbëjnë 35.4 përqind të gjithsej eksporteve të Kosovës. Sa i përket tregtisë me vendet individuale të CEFTA-s, Shqipëria vazhdon të jetë partner i rëndësishëm tregtar i Kosovës, me pjesëmarrje prej 17.4 përqind në gjithsej eksportet. Në qershor 2009, eksportet e Kosovës në Shqipëri u rritën për 28.7 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Eksportet e Kosovës në Maqedoni shënuan rënie vjetore prej 22.6 përqind, mirëpo pjesëmarrja e tyre në gjithsej eksportet u

rrit për 3.0pp. Ndërsa, eksportet e Kosovës drejtë Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës vazhdojnë të hasin pengesa nga ana e këtyre shteteve. Si rezultat i kësaj bllokade, eksportet e Kosovës drejt këtyre dy vendeve përbëjnë vetëm 1.5 përqind të gjithsej eksporteve, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2008 përfaqësonin rreth 8.4 përqind të gjithsej eksporteve.

**Tabela 4. Eksportet e Kosovës në BE dhe CEFTA, (kumulative brenda vitit kalendarik)**

|                           | qershor 2007 |              | qershor 2008 |              | qershor 2009 |              |
|---------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
|                           | milionë euro | përqind      | milionë euro | përqind      | milionë euro | përqind      |
| <b>Vendet e BE-së</b>     | <b>25.5</b>  | <b>34.1</b>  | <b>53.8</b>  | <b>51.5</b>  | <b>26.9</b>  | <b>42.9</b>  |
| Holanda                   | 1.3          | 1.7          | 1.2          | 1.2          | 0.8          | 1.2          |
| Gjermania                 | 3.0          | 4.0          | 4.3          | 4.1          | 2.7          | 4.2          |
| Greqia                    | 3.8          | 5.0          | 8.0          | 7.7          | 0.2          | 0.3          |
| Italia                    | 5.6          | 7.4          | 9.1          | 8.7          | 18.5         | 29.6         |
| Belgjika                  | 0.0          | 0.0          | 21.5         | 20.6         | 0.7          | 1.1          |
| <b>Vendet e CEFTA-s</b>   | <b>33.1</b>  | <b>44.2</b>  | <b>30.7</b>  | <b>29.4</b>  | <b>22.2</b>  | <b>35.4</b>  |
| Shqipëria                 | 11.1         | 14.8         | 8.5          | 8.2          | 10.9         | 17.4         |
| Bosnja dhe Hercegovina    | 2.6          | 3.5          | 4.0          | 3.9          | 0.5          | 0.8          |
| Kroacia                   | 1.3          | 1.7          | 0.5          | 0.5          | 0.6          | 1.0          |
| Maqedonia                 | 8.5          | 11.3         | 10.9         | 10.5         | 8.5          | 13.5         |
| Serbia                    | 8.4          | 11.2         | 4.7          | 4.5          | 0.5          | 0.8          |
| Mali i Zi                 | 1.3          | 1.7          | 2.0          | 1.9          | 1.3          | 2.1          |
| <b>Tjera</b>              | <b>16.2</b>  | <b>21.7</b>  | <b>19.8</b>  | <b>19.0</b>  | <b>13.5</b>  | <b>21.6</b>  |
| Turqia                    | 1.4          | 1.9          | 1.4          | 1.4          | 3.1          | 4.9          |
| Zvicra                    | 6.6          | 8.9          | 4.7          | 4.5          | 2.9          | 4.6          |
| India                     | 0.0          | 0.0          | 8.5          | 8.2          | 4.6          | 7.3          |
| <b>Gjithsej Eksportet</b> | <b>74.9</b>  | <b>100.0</b> | <b>104.4</b> | <b>100.0</b> | <b>62.7</b>  | <b>100.0</b> |

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, pjesëmarrja e mallrave të importuara nga vendet anëtare të BE-së në gjithsej importet e Kosovës ishte 38.3 përqind (Tabela 5). Në kuadër të vendeve të BE-së, Gjermania është vendi prej të cilit Kosova importon pjesën më të madhe të mallrave (13.0 përqind e gjithsej importeve), vlera monetare e të cilave në qershor 2009 shënoi një rritje vjetore prej 36.6 përqind. Importet nga vendet anëtare të CEFTA-s gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 përfaqësuan 34.5 përqind të gjithsej importeve, ndërsa vlera monetare e tyre kishte një rënie vjetore prej 10.6 përqind. Në qershor 2009, importet nga Maqedonia pësuan rënien më të lartë ndër vendet e rajonit. Vlera e mallrave të importuara nga Maqedonia shënoi një rënie vjetore prej 24.0 përqind, ndërsa në qershor 2009, pjesëmarrja e tyre në gjithsej importet e Kosovës u zvogëlua në 15.1 përqind (nga 19.5 përqind në qershor 2008). Megjithatë, mallrat e importuara nga Maqedonia vazhdojnë të përfaqësojnë pjesën më të madhe të importeve të Kosovës.

**Tabela 5. Importet e Kosovës nga BE dhe CEFTA, (kumulative brenda vitit kalendarik)**

|                          | qershor 2007 |              | qershor 2008 |              | qershor 2009 |              |
|--------------------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|
|                          | milionë euro | përqind      | milionë euro | përqind      | milionë euro | përqind      |
| <b>Vendet e BE-së</b>    | <b>253.7</b> | <b>36.4</b>  | <b>307.6</b> | <b>36.0</b>  | <b>322.1</b> | <b>38.3</b>  |
| Gjermania                | 70.4         | 10.1         | 79.8         | 9.3          | 109.0        | 13.0         |
| Greqia                   | 32.1         | 4.6          | 35.1         | 4.1          | 35.6         | 4.2          |
| Italia                   | 26.6         | 3.8          | 33.3         | 3.9          | 34.6         | 4.1          |
| Sllovenia                | 26.3         | 3.8          | 30.1         | 3.5          | 30.2         | 3.6          |
| Bullgaria                | 19.5         | 2.8          | 21.4         | 2.5          | 19.4         | 2.3          |
| <b>Vendet e CEFTA-s</b>  | <b>253.3</b> | <b>36.3</b>  | <b>324.2</b> | <b>37.9</b>  | <b>290.0</b> | <b>34.5</b>  |
| Shqipëria                | 16.3         | 2.3          | 27.4         | 3.2          | 24.3         | 2.9          |
| Bosnja dhe Hercegovina   | 12.1         | 1.7          | 16.3         | 1.9          | 20.8         | 2.5          |
| Kroacia                  | 15.5         | 2.2          | 19.8         | 2.3          | 20.7         | 2.5          |
| Maqedonia                | 104.1        | 14.9         | 166.9        | 19.5         | 126.8        | 15.1         |
| Mali i Zi                | 5.7          | 0.8          | 5.5          | 0.6          | 5.0          | 0.6          |
| Serbia                   | 99.5         | 14.3         | 88.2         | 10.3         | 92.3         | 11.0         |
| <b>Tjera</b>             | <b>190.0</b> | <b>27.3</b>  | <b>223.1</b> | <b>26.1</b>  | <b>228.7</b> | <b>27.2</b>  |
| Turqia                   | 49.7         | 7.1          | 60.2         | 7.0          | 68.4         | 8.1          |
| Kina                     | 45.3         | 6.5          | 47.2         | 5.5          | 57.5         | 6.8          |
| <b>Gjithsej Importet</b> | <b>696.9</b> | <b>100.0</b> | <b>854.8</b> | <b>100.0</b> | <b>840.8</b> | <b>100.0</b> |


Sa i përket tregtisë së shërbimeve, deri në qershor 2009 pranimet nga shërbimet arritën vlerën prej 220.9 milionë euro, ndërsa pagesat për shërbime arritën vlerën prej 158.2 milionë euro. Rrjedhimisht, bilanci i shërbimeve shënoi suficit prej 62.7 milionë euro, duke ndikuar kështu në zbutjen e deficitit në llogarinë rrjedhëse. Që nga viti 2004, bilanci pozitiv i shërbimeve kryesisht shpreh suficitin e shërbimeve të udhëtimit (57.3 milionë euro në qershor 2009) dhe atë të shërbimeve qeveritare (62.9 milionë euro). Sa i përket pranimeve nga shërbimet e udhëtimit, kontribues kryesorë janë stafi ndërkombëtar dhe emigrantët e kosovar. Ndërsa, sa i përket shërbimeve qeveritare, kontributi më i madh i atribuohet ofrimi i shërbimeve për përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare në Kosovë. Bilanc negativ prej 44.4 milionë euro regjistruan shërbimet biznesore, në të cilat kontributin kryesor e kanë dhënë pagesat për shërbime në formë të asistencës teknike. Një kategori tjetër e rëndësishme e shërbimeve në Kosovë janë shërbimet e komunikimit, vlera neto e të cilave deri në qershor 2009 arriti suficit prej 14.0 milion euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shërbimet e komunikimit pësuan rënie vjetore për rreth 33 përqind.

#### 4.1.2. Të ardhurat dhe transferet rrjedhëse

Llogaria e të ardhurave përbëhet nga të ardhurat e përfituara nga faktorët e prodhimit, si puna dhe kapitali i rezidentëve të një vendi në vendet tjera. Rrjedhimisht, llogaria e të ardhurave përbëhet nga kompensimet e punëtorëve dhe të ardhurat nga investimet. Deri në qershor 2009, të ardhurat shënuan

suficit prej 52.3 milionë euro, i cili rrjedhë nga bilanci pozitiv i kompensimit të punëtorëve. Kompensimi i punëtorëve përbën kategorinë dominuese të gjithsej të ardhurave (Figura 8). Të hyrat nga kompensimi i punëtorëve gjatë gjysmës së parë të vitit 2009 arritën vlerën neto prej 79.7 milionë euro (80 përqind të gjithsej të hyrave). Sa i përket të ardhurave nga investimet, ato arritën vlerën prej 9.6 milion euro për gjatshëmujorin e parë të vitit 2009. Të ardhurat neto nga investimet shënuan bilanc prej -27.4 milionë euro krahasuar me -5.5 milion euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Gjithashtu, deri në qershor 2009, për shkak të krizës financiare globale, kthimi nga investimet institucioneve financiare ishte 8.0 milion euro (26.4 milionë euro deri në qershor 2008).

**Figura 8. Të ardhurat, në milionë euro**




Fitimet nga investimet e jorezidentëve në Kosovë arritën në 33.4 milionë euro (krahasuar me rreth 6 milionë në gjatshëmujorin e parë të vitit paraprak). Të hyrat e jorezidentëve nga investimet në Kosovë kryesisht përbëhen nga fitimet e bankave komerciale. Prej tyre, 29.6 milionë euro përbëhen nga të ardhurat e riinvestuara, ndërsa pjesa e mbetur prej 3.8 milionë euro janë paguar në formë dividende nga kompanitë private ndaj subjekteve jorezidente.

Kategori tjetër mjaft e rëndësishme në llogarisë rrjedhëse janë transferet rrjedhëse të cilat paraqesin pranimet ose pagesat e burimeve reale ose financiare, shërbime apo mjete financiare, pa kompensim ose mjete të falura në formë dhurate. Deri në qershor 2009, transferet rrjedhëse neto arritën vlerën prej 370.1 milionë euro dhe, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, pësuan rënie vjetore prej rreth 11 përqind (Figura 9). Kjo rënie kryesisht mund i atribuohet rënies së

transfereve neto të sektorit privat prej rreth 17 përqind, të cilat në këtë gjashtëmuor arritën në 222.3 milionë euro.

**Figura 9. Bilanci i transfereve rrjedhëse**



Transferet e sektorit privat kryesisht përbëhen prej dërgesave të emigrantëve. Deri në qershor 2009, dërgesat e emigrantëve janë vlerësuar të kenë arritur në 222.8 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore për rreth 11.0 përqind. Rënia vjetore e dërgesave të emigrantëve në Kosovë është përafërsisht e ngjashme me vendet e rajonit. Rënia e dërgesave të emigrantëve në Kosovë kryesisht vjen si pasojë e krizës, e cila rriti nivelin e papunësisë edhe në vendet e eurozonës, vende këto ku kryesisht janë të koncentruar emigrantët kosovarë. Kjo rënie mund të ketë implikime negative edhe për aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vend duke pasur parasysh se një pjesë e madhe e konsumit financohet nga dërgesat e emigrantëve. Në anën tjetër, transferet dalëse të rezidentëve të huaj që punojnë në Kosovë (kryesisht stafi ndërkombëtar) shënuan vlerën prej 40.6 milionë nga rreth 47 milion sa ishin në gjysmën e parë të vitit 2008.


### **Kutia 3. Metodologjia e llogaritjes së dërgesave të emigrantëve**

Dërgesat e emigrantëve në Kosovë përbëjnë një përqindje domethënëse të PBB-së (14%) dhe tejkalojnë në mënyrë të konsiderueshme nivelin e Investimeve të Huaja Direkte, duke arritur në gati 1.5 herë më shumë se sa IHD-të për vitin 2008.

Dërgesat e emigrantëve mund të jenë mallra ose mjete financiare nga emigrantët që jetojnë dhe punojnë në vendet tjera, të transferuara tek rezidentët në Kosovë. Emigranti është një person i cili shkon në një ekonomi tjetër dhe qëndron atje për një ose më shumë vite. Duke u bazuar në këtë definicion, për vlerësimin e dërgesave të emigrantëve, nuk janë trajtuar dërgesat nga punëtorët me qëndrim të përkohshëm në vendet tjera (më pak se një vit), si dhe paratë e dërguara në Kosovë nga

emigrantët me qëllim të blerjes së patundshmërive ose për investime tjera. Sa i përket kanaleve për transferimin e dërgesave të emigrantëve, me qëllim të vlerësimit të dërgesave të emigrantëve, përveç kanalit institucional që i referohet institucioneve financiare (bankat komerciale dhe agjensionet për transferimin e parave) është vlerësuar edhe kanali jo-institucional i transferimit të dërgesave të emigrantëve që i referohet transfereve në formë të mallrave si dhe dërgesave të cilat emigrantët i sjellin në formë të parasë së gatshme me rastin e vizitave familjeve të tyre. Nëpërmjet këtij kanali transferohen rreth 65 përqind e dërgesave të emigrantëve.

**Figura 10. Dërgesat e emigrantëve**



Zvogëlimi i kostos inkurajon transferimin e dërgesave të emigrantëve përmes kanaleve institucionale si dhe kontribuon në një zhvendosje më të madhe nga sektori jo-institucional drejt atij institucional. Në kuadër të këtij kanali, agjensionet për transferimin e parave, paraqitën mënyrën më të përdorur për transferimin e dërgesave nga emigrantët, pasi që rreth 40 përqind e tyre vinin nëpërmjet këtij kanali, ndërsa dërgesat e emigrantëve të transferuara nëpërmjet bankave komerciale përfaqësonin rreth 26 përqind të gjithë dërgesave të emigrantëve.

Transferimi i dërgesave nëpërmjet kanaleve jo-institucionale është zvogëluar në vazhdimësi. Në këtë trend rënës mund të ketë ndikuar, në mes tjerash, edhe rregullorja mbi doganat, e cila ka përcaktuar që personat të cilët posedojnë më shumë se 10,000 euro duhet t'i deklarojnë ato në momentin e arritjes në Kosovë, si dhe rregullorja mbi parandalimin dhe zbulimin e shpërlarjes së parasë dhe financimin e aktiviteteve terroriste.

#### 4.2. Llogaria kapitale dhe financiare

Llogaria kapitale dhe financiare vazhdon të ketë bilanc pozitiv. Deri në qershor 2009 ky bilanc arriti në 243.0 milion euro, që krahasuar me vitin paraprak është më i lartë për rreth 5 përqind. Llogaria kapitale ka shënuar një ngritje të lehtë gjatë gjysmës së parë të vitit 2009, mirëpo vlera në këtë llogari vazhdon të jetë e ulët (7.1 milion euro deri në qershor 2009). Sa i përket llogarisë financiare, në pjesën

e parë të vitit 2009 shënoi një rritje prej rreth 4 përqind, rritje kjo e cila në masën më të madhe vjen si rezultat i rritjes së kredive tregtare si dhe rënies së investimeve në letra me vlerë.

#### 4.2.1. Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte paraqesin kategori të rëndësishme në bilancin e pagesave të Kosovës. Deri në qershor të vitit 2009, vlera neto e IHD-ve arriti në 127.4 milion euro, shumë kjo e cila paraqet një rënie prej rreth 25 përqind krahasuar me gjysmën e parë të vitit paraprak. Nga kjo shumë e IHD-ve, 133.1 milion euro janë investime të kompanive të huaja në Kosovë, ndërsa 5.7 milion euro paraqet investimet e shtetasve të Kosovës jashtë vendit, kryesisht për blerjen e patundshmërisë.


Si rezultat i krizës ekonomike, shumë kompani pësuan humbje, duke rezultuar në ndryshim të planeve për investime jashtë vendeve të tyre. Investimet kapitale përbëjnë pjesën më të madhe të IHD-ve në Kosovë me rreth 66.8 përqind (85.2 milion euro). Investimet të cilat i takojnë kësaj kategorie gjatë kësaj pjese të vitit shënuan rënie prej rreth 13 përqind krahasuar me pjesën e parë të vitit paraprak. Formë tjetër e rëndësishme e IHD-ve janë edhe fitimet e riinvestuara nga kompanitë e huaja të cilat aktualisht veprojnë në Kosovë. Kjo formë përbën rreth 23 përqind të gjithsej IHD-ve ose 29.6 milion euro. Në kategorinë e investimeve të fitimit të pashpërndarë mund të vërehet një rënie prej rreth 5 përqind krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2008. IHD-të e formave tjera kanë një pjesëmarrje prej 9.8 përqind. Këto investime, janë kryesisht kredi për kompanitë që veprojnë në Kosovë nga kompanitë të cilat veprojnë jashtë vendit dhe arritën shumë prej 12.6 milion euro në gjysmën e parë të vitit 2009 (rreth 44 milion euro në gjysmën e parë të vitit paraprak).

Faktorët të cilët mund të kenë ndikuar negativisht IHD-të gjatë gjashtë muajve të parë të 2009, mund të konsiderohen fitimi më i ulët i bankave dhe kompanive tjera jo financiare të cilat operojnë në Kosovë. Rënie të investimeve kishte edhe në sektorin e telekomunikimit, mirëpo kjo ishte rezultat i investimeve të larta në vitet paraprake (2007-2008) kur edhe u licencua kompania e dytë e telefonisë mobile. Për më tepër, rifillimi i procesit të privatizimit në fundin e vitit 2008 ka ndikuar pozitivisht në thithjen e IHD-ve, e sidomos në investimet kapitale. Gjatë pjesës së parë të vitit 2009, procesi i privatizimit ka pasur ndikim pozitiv në IHD. Në kuadër të këtij procesi, gjatë pjesës së parë të vitit 2009 15.2 milion euro ishin IHD, krahasuar me 4.3 milion në vitin paraprak.

IHD-të deri në fund të vitit 2008 kryesisht ishin të drejtuara në sektorin financiar, të cilat përfaqësonin rreth 35 përqind të gjithsej IHD-ve. Gjatë vitit 2008, përveç investimeve nga bankat të cilat vepronin në Kosovë, kishte edhe hyrje të bankave të reja në tregun kosovar. Investimet në

patundshmëri gjithashtu gjatë vitit 2008 rritën pjesëmarrjen në IHD-të e përgjithshme në masë të konsiderueshme. Siç edhe shihet në figurën 11, investimet në patundshmëri kanë pjesëmarrje të konsiderueshme, duke përfaqësuar 16.8 përqind të IHD-ve gjatë vitit 2008.

**Figura 11. Struktura e IHD-ve sipas sektorëve**



Potencialet në Kosovë përbëjnë një mundësi të madhe për zhvillim ekonomik si dhe për tërheqje të investitorëve të huaj. Ky sektor ka rritur pjesëmarrjen në investimet e huaja, ndërsa mund të vlerësohet si sektor strategjik kur kemi parasysh planet për ndërtimin e hidrocentraleve dhe termocentralit “Kosova e Re”. Planifikimi për privatizimin e Post-Telekomit të Kosovës dhe dhënia me koncesion e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës paraqesin mundësi të mëdha për investitorët e huaj si dhe për ekonominë e Kosovës pasi që këto ndërmarrje vlerësohet si ndërmarrjet më fitimprurëse në Kosovë.

#### 4.2.2. Investimet në letra me vlerë dhe investimet e tjera

Investimet e bankave komerciale në letra me vlerë u zvogëluan si rezultat i disa tërheqjeve, ndërsa Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) nuk ndërmori ndonjë investim gjatë kësaj periudhe. Kjo sjellje erdhi si rezultat i performancës jo të mirë në tregjet e letrave me vlerë, të kapitalit si dhe të instrumenteve të tjera në tregjet financiare gjatë gjysmës së parë të vitit 2009. Fondet të cilat më parë ishin të investuara në letra me vlerë dhe aksione i’u ndryshua destinacioni duke u zhvendosur në investime tjera, kryesisht në depozita, instrumente këto që konsiderohen më të sigurta. Investimet në letra me vlerë u zvogëluan për 27.2 milion euro për gjashtë muajt e parë të vitit 2009. Investimet e tjera janë të përbëra nga kreditë tregtare, kreditë, depozitat si dhe nga investimet në tregjet e valutave. Gjatë gjysmës së parë të këtij viti, kjo kategori shënoi bilanc pozitiv që është, afërsisht, dyfishi i

bilancit të vitit paraparak. Arsyeja kryesore pse këto investime shënuan një rritje kaq të lartë është rritja e kredive tregtare.

Asetet e Kosovës në kategorinë e investimeve tjera gjatë kësaj gjysmës së parë të vitit 2009 u rritën dukshëm duke arritur 42.4 milion euro, ndërsa gjatë gjithë vitit 2008 investimet në këtë kategori ishin 19.8 milion euro. Mbi 98 përqind e këtyre investimeve janë të drejtuara në depozita, të realizuara në masë dominuese nga BQK-ja, ndërsa një pjesë mjaft e vogël i takon kategorive të kredive tregtare si dhe kredive tjera.

Në anën e detyrimeve, peshën kryesore të kësaj kategorie e përbëjnë investimet e kompanive të huaja në Kosovë në formë të kredive tregtare ndaj kompanive në Kosovare (64.1 përqind e të gjitha investimeve). Si formë e dytë për nga pesha e investimeve tjera në Kosovë janë kreditë të cilat kanë një pjesëmarrje prej 25.3 përqind të gjithsej investimeve. Këto kredi janë kredi afatgjata të cilat sektorët e tjerë në Kosovë i kanë marrë nga jashtë vendit. Kategoria e depozitave ka një përfaqësim më të vogël (me rreth 10 përqind) në kategorinë e investimeve tjera, dhe janë depozita të jo-rezidentëve në bankat në Kosovë (kryesisht stafi i ndërkombëtar në Kosovë si dhe depozita të emigrantëve Kosovar).

Asetet rezervë të Kosovës në gjysmën e parë të vitit 2009 u rritën edhe për 15.8 milion euro. Kjo përbëhet prej 43.7 milion euro rritje në tremujorin e parë të vitit 2009, si dhe prej 27.9 milion euro rënie në tremujorin e dytë.

## 5. Shënime metodologjike

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) është përgjegjëse për përpilimin e statistikave mbi Bilancin e Pagesave (BP) të Kosovës. Baza ligjore për mbledhjen e informatave dhe përpilimin e statistikave për BP-në është e paraparë me ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Burimet kryesore të të dhënave për statistikën e BP-së janë: Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN), Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Anketat e Ndërmarrjeve (AN), dhe raporte tjera nga Institucionet Qeveritare. Të dhënat janë të plotësuara me informatat e marra nga burimet tjera (UNMIK-u, EULEX-i dhe Donatorët) si dhe me vlerësimet e BQK-së. Përpilimi i statistikave të BP-së është bërë në pajtim me Manualin e Bilancit të Pagesave të FMN-së, botimi i pestë (BPM5). Statistikat e BP-së kanë filluar të përpilohen për herë të parë nga BQK-ja në vitin 2006 duke përfshirë periudhën 2004-2005. Deri më tani, statistikat e BP-së janë publikuar në bazë vjetore, mirëpo që nga viti 2009 (Buletini i Bilancit të Pagesave nr. 9) statistikat e BP-së përpilohen dhe publikohen në baza tremujore.

Bilanci i pagesave paraqet informacion kyç ekonomik dhe përmbledhë në mënyrë sistematike transaksionet ekonomike të rezidentëve të Kosovës me botën e jashtme, për një periudhë të caktuar kohore. Transaksionet ekonomike janë transaksione të regjistruara si transaksione hyrëse (pranime) dhe transaksione të dalëse (pagesa). Pranimet nga jashtë janë të regjistruara si kredi dhe përfshijnë transaksionet ekonomike si eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet e të ardhurave, të hyrat financiare si dhe transaksionet tjera hyrëse. Në anën tjetër pagesat nga ana e qytetarëve vendës ndaj botës së jashtme (jo rezidentëve) regjistrohen si debi dhe përfshijnë transaksionet ekonomike si: importin e mallrave, importin e shërbimeve, fluksi dalës i të ardhurave, fluksi dalës financiar dhe transfertat dalëse.

Në mënyrë konceptuale, një transaksion ekonomik i ka dy anë: diçka me vlerë ekonomike jepet dhe diçka me vlerë të njëjtë merret nëpërmes të sistemit të regjistrimit të dyfishtë. Kur jepet një vlerë ekonomike, (p.sh eksportet e Kosovës) regjistrohet një kredi, ndërsa kur një vlerë ekonomike merret (p.sh importet e Kosovës) regjistrohet një debi. Kur diçka me vlerë ekonomike merret pa ndonjë vlerë ekonomike si këmbim, sistemi i regjistrimit të dyfishtë kërkon një shlyerje si imput (regjistrim transferi) me vlerë ekuivalente. P.sh ushqimi i importuar si ndihma kërkon një debi të hyrë për llojin e mallit dhe një transfer kredie si shlyerje. Shembulli i mëposhtëm ilustron se si aplikohet sistemi i regjistrimit të dyfishtë. Sipas përcaktimit të sistemit të regjistrimit të dyfishtë, hyrjet në kredi duhet të jenë të barabarta me hyrjet në debi.

| Hyrjet në kredi   | Hyrjet në debi   |
|---|--|
| Ndryshimet në të gjitha resurset ekonomike të ofruara nga kosovarët tek jorezidentët, duke përfshirë: | Ndryshimet në të gjitha resurset ekonomike të marra nga kosovarët prej jorezidentët, duke përfshirë: |
| - Eksporti i mallrave dhe shërbimeve  | - Importi i mallrave dhe shërbimeve  |
| - Të ardhurat e pranuar   | - Të ardhurat e paguara  |
| - Transfertat të cilat shlyhen me hyrjet në debi  | - Transfertat të cilat shlyhen me hyrjet në kredi  |
| - Rritja në detyrimet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve  | - Rritja në pretendimet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve                                     |
| - Zvoglimi në asetet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve   | - Zvoglimi në pretendimet financiare të Kosovës ndaj jorezidentëve.                                  |

### Kriteri i rezidencës

Rezidentët e Kosovës janë subjekte ligjore që janë të regjistruar dhe që veprojnë në Kosovë dhe persona fizik vendbanimi i të cilëve gjendet në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për periudhë më të gjatë se një vit (përveç diplomatëve, studentëve dhe pacientëve medicinal). Për shkak të specifikës, një theks i veçantë i është dhënë trajtimit të UNMIK-ut, EULEX-it, KFOR-it, dhe stafit tjetër ndërkombëtar në Kosovë.

### Trajtimimi i UNMIK-ut/EULEX-it

Bazuar në kriterin e rezidencës (BPM5, paragrafi 88), UNMIK-u dhe EULEX-i janë organizata ndërkombëtare dhe si rezultat plotësojnë kushtet për tu klasifikuar si jorezident në Kosovë. Në këtë rast, dallimi duhet bërë ndërmjet institucionit të UNMIK-ut/EULEX-it dhe stafit që punon në këto institucione. Kështu, UNMIK-ut/EULEX-i si institucione janë trajtuar si jorezidentë të Kosovës, kurse stafi që punon në këto dy institucione është trajtuar (1) rezident, nëse kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre në Kosovë është mbi një vit, dhe (2) jo rezidentë, nëse kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në Kosovë është nën një vitë.

Metodologjia për kalkulimin e shpenzimeve të UNMIK-ut/EULEX-it bazohet në publikimin e UNMIK-ut "Ndikimi i UNMIK-ut në Ekonominë e Kosovës" i publikuar në korrik 2006. Të dhënat mbi UNMIK-ut/EULEX-in azhurnohen në bazë të informatave që sigurohen drejtpërdrejt nga UNMIK-ut/EULEX-i.

Supozimet dhe vlerësimet për transaksionet e UNMIK-ut/EULEX-it si institucion dhe stafi janë si më poshtë:

- Shpenzimet e UNMIK-ut/EULEX-it (si institucion) për mallrat dhe shërbimet e blera nga kompanitë kosovare konsiderohen si import i UNMIK-ut/EULEX-it i mallrave dhe shërbimeve lokale (eksporte të shërbimeve qeveritare të Kosovës).
- Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it që konsiderohen rezident shpenzojnë rreth 14% të pagave të tyre në Kosovë. Pjesa e mbetur prej 76% dërgohet në vendet e tyre (si dërgesa parash) dhe 10% shpenzohet për të udhëtuar jashtë (shërbime udhëtimi).
- Stafi ndërkombëtar i UNMIK-ut/EULEX-it si jorezident (stafi ndërkombëtar afatshkurtër i UNMIK-ut/EULEX-it) shpenzojnë 14% të pagës së tyre në Kosovë për shpenzime të jetesës.

Nëpërmes një shembulli hipotetik jemi përpjekur që të paraqesim implikimin e UNMIK-ut/EULEX-it në BP të Kosovës, të bazuar në supozimet e lartpërmendura:

Duke supozuar që buxheti i UNMIK-ut është 100 €, përpjestimi është si më poshtë:

|   |            |
|---|------------|
| — Pagat e stafit <i>rezident</i> ndërkombëtar   | 60         |
| — Pagat e stafit <i>jorezident</i> ndërkombëtar | 3          |
| — Pagat e stafit lokal                          | 17         |
| — Mallrat e importuara                          | 8          |
| — Mallrat lokale të importuara                  | 2          |
| — Shërbimet e importuara                        | 6          |
| — Shërbimet lokale të importuara                | 4          |
| <b>Totali i buxhetit të UNMIK-ut/EULEX-it</b>   | <b>100</b> |

Duke aplikuar shembullin e lartëcekur në sistemin e regjistrimit të dyfishtë, shënimet në BP do të jenë si më poshtë:

|  | Kredi | Debi |
|--|-------|------|
| Llogaria rrjedhëse   |       |      |
| Shërbimet e udhëtimit  |       |      |
| Shpenzimet e jetesës së stafit jorezident të UNMIK-ut (14% * 3)                      | 0.4   |      |
| Shpenzimet e stafit rezident të UNMIK-ut/EULEX-it për të udhëtuar jashtë (10% * 60)  |       | -6.0 |
| Pagat e stafit jorezident të UNMIK-ut/EULEX-it                                       |       | -3.0 |
| Shërbimet e tjera të biznesit  |       |      |
| Shpenzimet e UNMIK-ut/EULEX-it (si institucion) për mallra dhe shërbime lokale (2+4) | 6.0   |      |
| Transfertat rrjedhëse  |       |      |
| Totali i pagave të stafit të UNMIK-ut (60+3+17)                                      | 80.0  |      |
| Dërgesat e emigrantëve (76%*60)  | -45.6 |      |

Për shkak të trajtimit të lartpërmendur të UNMIK-ut, shpenzimet e tij për importimin e mallrave dhe shërbimeve, përveç atyre që blihen në Kosovë, konsiderohen si transaksione ndërmjet jorezidentëve, prandaj nuk paraqiten në statistikat e BP-së. Në mënyrë të ngjajshme me UNMIK-un janë trajtuar edhe transaksionet e EULEX-it.

### Trajtimi i KFOR-it

KFOR-i është forcë ndërkombëtare që udhëhiqet nga NATO-ja dhe që është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurt në Kosovë. KFOR ka hyrë në Kosovë më 12 qershor, 1999 me një mandat të Kombeve të Bashkuara, pas miratimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244. KFOR është kontingjent ushtarak, dhe si i tillë është jorezident i Kosovës.

### Trajtimi i Stafit Ndërkombëtar në Kosovë (me përjashtim të stafit të UNMIK-ut/EULEX-it)

Në pajtim me SNA 93 dhe BPM5 stafi ndërkombëtar në Kosovë i angazhuar në ofrimin e ndihmës teknike apo aktiviteteve tjera në të mirë të institucioneve të Kosovës, trajtohet në bazë të kohëzgjatjes së qëndrimit të tyre. Sidoqoftë, stafi ndërkombëtar i Ambasadave dhe zyrave tjera të organizatave tjera në Kosovë (diplomatët, personeli ushtarak, dhe punëtorët tjerë të organizatave të tilla si dhe

anëtarët e familjeve të tyre, të cilët banojnë në Kosovë dhe gëzojnë imunitetin dhe privilegjet diplomatike) trajtohen si jorezidentë të Kosovës.

### LLOGARIA RRJEDHËSE

Llogaria rrjedhëse përbëhet nga blerjet dhe shitjet e mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat dhe transferatat rrjedhëse në mes të vendit dhe botës së jashtme.

- 1) **Mallrat.** Burimi i të dhënave mbi statistikën e tregtisë së jashtme janë Doganat e Kosovës, të procesuara nga ESK-ja. BQK-ja, në baza mujore pranon të dhëna mbi statistikën e tregtisë së jashtme nga ESK-ja, bazuar në marrvëshjen e bashkëpunimit në mes të dy institucioneve. BQK-ja bën përshtatjen për raportim dhe klasifikim duke aplikuar raportin c.i.f. / f.o.b. prej 7.1% (5.6% për transport dhe 1.5% për sigurim), me përjashtim të importit nga vendet fqinje të cilat vlerësohen sipas bazës f.o.b. Përshtatjet bëhen me anë të analizimit të vlerës c.i.f. kundrejt vlerës totale të importeve të mallrave për një periudhë specifike, bazuar në Dokumentin Unik Doganor (DUD);
- 2) **Shërbimet.** Tregtia në shërbime paraqet provizionin e shërbimeve të rezidentëve ndaj jorezidentëve dhe anasjelltas. Komponenti i shërbimeve të BP-së përbëhet nga: transporti, udhëtimi, shërbimet qeveritare (që nuk përfshihen diku tjetër) dhe shërbimet tjera të cilat ndahen më tej në njësi tjera (komunikim, ndërtim, sigurime, financiare, kompjuterikë dhe informatikë, tarifatat për të drejtën autoriale dhe licencën, shërbime tjera biznesore, shërbime personale dhe qeveritare);
  - a. *Transporti* përfshinë transportin detar, ajror, dhe transportet tjera (p.sh. hekurudhore, tokësore dhe transporti i gazit). Këtu përfshihen lëvizjet e pasagjerëve, transporti i mallrave dhe shërbimet tjera të transportit, si: marrja me qira e aeroplanit dhe ekuipazhit, bartja e ngarkesave, magazinimi, rimorkiot, pilotimi dhe navigimi, mirëmbajtja dhe pastrimi, si dhe tarifatat dhe komisionet e agjentëve të shoqëruara me transportimin e pasagjerëve/mallrave. Transporti i pasagjerëve vlerësohet në bazë të mesatares së fluturimeve nëpërmes të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës të shumëzuar me çmimin mesatar të një bilete. Të dhënat për transportimin e pasagjerëve janë marrë nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Vlera e shërbimeve për transportimin e mallrave caktohet duke u bazuar në ndryshimin në mes të vlerës së mallrave të importuara në c.i.f. dhe f.o.b. (si debi). Raporti i transportit të mallrave kundrejt shumës totale të importeve c.i.f. konsiderohet të jetë 5.6%. Marrja e komisioneve dhe tarifave të agjentit për shërbimet e ndërlidhura të transportit si dhe tarifatat e aeroportit për aterim regjistrohen si kredi;
  - b. *Shërbimet e udhëtimit* përfshijnë shërbimet që u ofrohen jorezidentëve gjatë udhëtimeve në Kosovë (kredi), dhe që u ofrohen rezidentëve të Kosovës gjatë udhëtimeve të ngjashme jashtë vendit (debi). Përjashtim bën personeli ushtarak dhe diplomatik (p.sh. KFOR dhe Ambasadat), shpenzimet e të cilëve llogariten si shërbime qeveritare.
    1. *Udhëtime biznesi.* Udhëtimi biznesor përfshinë të gjitha llojet e udhëtimeve që kanë të bëjnë me aktivitetet e biznesit; udhëtimet zyrtare të punëtorëve të qeverisë; udhëtimet zyrtare të punëtorëve të organizatave ndërkombëtare (p.sh. asistencë teknike); dhe

punëtorët e ndërmarrjeve që nuk janë rezidentë në atë ekonomi. Udhëtimet biznesore vlerësohen në bazë të të dhënave nga ndërmarrjet dhe të dhënave nga SRTN-ja.

2. *Udhëtimi personal* përfshinë të gjithë udhëtarët të cilët udhëtojnë jashtë Kosovës dhe kthehen në Kosovë që nuk përfshihen në udhëtimet biznesore. Këtu gjithashtu përfshihen shpenzimet e akomodimit të stafit afatshkurtër të UNMIK-ut/EULEX-it (rezident) në Kosovë (në anën kredi) dhe shpenzimeve për udhëtim jashtë vendit të stafit afatgjatë të UNMIK-ut/ EULEX-it (jorezident), që konsiderohen si rezident të Kosovës (në anën debi). Supozohet se, stafi afatshkurtër ndërkombëtar shpenzon rreth 14 % të pagës së tyre në Kosovë. Ky vlerësim është bërë duke u bazuar në një studim të Zyrës për Politika Ekonomike të Shtyllës së 4-të të UNMIK-ut. Burim tjetër me rëndësi i informatës për udhëtimin personal është nxjerr nga Anketa e Buxhetit të Ekonomisë Familjare, lidhur me konsumin e diasporës kosovare gjatë vizitave të tyre në Kosovë. Vlerësimi i shpenzimeve të kosovarëve lidhur me udhëtimet për pushime është bërë duke i ndërthurur informatat nga bankat qendrore në rajon (Banka e Shqipërisë dhe Banka Qendrore e Malit të Zi), si dhe të dhënat e SRTN-së.

c. *Shërbimet Qeveritare* (që nuk përfshihen diku tjetër). Janë kategori e mbetur që mbulon transaksionet e shërbimeve qeveritare (duke përfshirë ato të organizatave ndërkombëtare) të cilat nuk përfshihen në klasifikimet e mëhershme. Shërbimet Qeveritare përfshijnë gjithashtu të gjitha transaksionet e ambasadave dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve KFOR-it. Burimet e të dhënave janë të ndryshme si: SRTN-ja, Ambasadat, Komunitat, etj.

d. *Shërbimet e tjera*. Në kuadër të kësaj kategorie janë të përfshira eksportet dhe importet e shërbimeve të komunikimit, shërbimet për ndërtim, shërbimet e sigurimit, shërbimet financiare, shërbimet kompjuterike dhe informative, tarifat e të drejtës së autorit dhe të licencimit, shërbimet personale, kulturore dhe argëtuese si dhe shërbime të tjera biznesore. Në kuadër të shërbimeve të tjera biznesore (debit) janë të regjistruara pagat e punonjësve ndërkombëtar të UNMIK-ut/EULEX-it sipas kontratës me afat nën një vit dhe të cilët trajtohen si jorezident. Burim i të dhënave janë anketat e ndërmarrjeve dhe SRTN-ja.

- 3) **Të Ardhurat**. Komponenti i të ardhurave ndërlidhet me të ardhurat e fituara nga dy faktorë të prodhimit: puna dhe kapitali. Si rrjedhojë, të ardhurat përbëhen nga kompensimi i punonjësve dhe të ardhurat nga investimet.

a. *Kompensimi i punonjësve* përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të paguara për punëtorët jorezident në vend, apo të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre. Kompensimi i punonjësve i paguar për kosovarët që punojnë për organizatat ndërkombëtare dhe KFOR-in, janë të regjistruara në anën e kredisë (me përjashtim të punonjësve vendor që punojnë për UNMIK-un/EULEX-in, të cilët regjistrohen në kuadër të transfertave rrjedhëse). Kompensimi i punonjësve kalkulohet duke u bazuar në burime të

ndryshme të informatave, përfshirë të dhënat e mbledhura drejtpërdrejt nga UNMIK-u/EULEX-i, KFOR-i, MEF-i, Ambasadat, dhe nga organizatat e tjera ndërkombëtare;

- b. *Të ardhurat nga investimet.* Mbulojnë pranimet dhe pagesat e të ardhurave të shoqëruara nga mjetet e jashtme financiare dhe detyrimet. Komponenti kryesor i të ardhurave nga investimet përfaqëson të ardhurat nga investimet direkte, portofoli dhe investimet e tjera. Forma më tipike e të ardhurave nga jashtë është interesi i fituar nga depozitat apo letrat me vlerë në bankat e huaja. Në anën e debitit janë të përfshira pagesat për investitorët direkt në Kosovë si: dividendët, fitimi i ri-investuar, pagesa e kamatës për huamarrjet nga jashtë, etj. Burimet kryesore të informatave mbi të hyrat nga investimet janë raportet e bankave komerciale, kompanitë e sigurimit dhe BQK-ja;
- 4) **Transferet.** Janë të hyra të kompensuara për resurset reale apo mjetet financiare të ofruara pa kthim të ndonjë të mire, shërbimi, apo mjeti financiar. Transfertat janë të identifikuara ndaras si transfere rrjedhëse ose kapitale;

a. *Transfertat kapitale* përbëhen prej transfertave të cilat (1) përfshijnë pronësinë e mjeteve fikse, (2) transfertave të fondeve të lidhura me, apo të kushtëzuara ndaj, përvetësimin apo disponimin të mjeteve fikse, ose (3) anulimi i detyrimeve nga kreditorët, pa pranimin e ndonjë vlere si kthim.


- b. *Transfertat rrjedhëse* janë të nën-ndara në ato të qeverisjes qendrore dhe sektorë të tjerë:
- i. Qeveria e përgjithshme përfshinë:
    - (1) Grantet për Buxhetin e Kosovës;
    - (2) Ndihma e donatorëve, në mallra (Programi i Investimeve Publike);
    - (3) Shpenzimet e drejtpërdrejta të UNMIK-ut/EULEX-it;
  - ii. Sektorët tjerë - transfertat rrjedhëse të të cilave ndahen më tej në:
    - (1) Remitancat/dërgesat e punëtorëve (kryesisht transfertat e emigrantëve);
    - (2) Transfertat tjera - përfshijnë premiumet e sigurimit dhe kërkesave, pensione, disa ndihmesa financiare për institucione të ndryshme.

Burimet kryesore të të dhënave për vlerësimin e transfertave rrjedhëse janë UNMIK-u, MEF-i (Njësia e Koordinimit me Donatorë), SRTN-ja dhe Anketa mbi Buxhetin Familjar (e zbatuar nga ESK-ja).

*Dërgesat e emigrantëve.* Mbulojnë transfertat rrjedhëse nga emigrantët të cilët janë të punësuar në ekonomitë e tjera dhe konsiderohen rezident atje. Emigranti është personi i cili vjen në një ekonomi dhe qëndron për një vit apo më tepër. Personat të cilët qëndrojnë në ekonomi të reja për më pak se një vit, konsiderohen jorezident; transaksionet e tyre janë të përshtatshme kryesisht për komponentin e kompensimit të punonjësve (BPM5, paragrafi 269 përmes 272).

*Vlerësimi i dërgesave nga emigrantët kosovar që jetojnë jashtë.* Vlerësimi i të hyrave nga dërgesat e emigrantëve është bërë duke u bazuar në kanalet kyçe të rrjedhjes së tyre. Një varietet i burimeve të të dhënave është përdorur për matjen e fluksit hyrës këtyre dërgesave. Kryesisht jemi fokusuar për identifikimin e fluksit të regjistruar që vjen nga kanalet zyrtare (bankat, ATM-të dhe parat e

deklaruar tek Autoritetet Doganore) dhe dërgesave të emigrantëve që vijnë përmes kanaleve joformale (të pa deklaruar, siç është keshi që kalon nëpërmjet të doganave, transaksionet jo në kesh si transferi i mallrave nga emigrantët që jetojnë jashtë (shiqoni skemën e mëposhtme).



*Vlerësimi i fluksit të jashtëm të të huajve të cilët konsiderohen rezident të Kosovës.* Në anën e debitit të dërgesave të emigrantëve përfshihen dërgesat përkitazi me (1) stafin ndërkombëtar - me punë afatgjate në UNMIK/EULEX dhe (2) stafin tjetër ndërkombëtar të përfshirë në projekte të tjera (p.sh. PiP). Vlerësohet se të ardhurat e stafit ndërkombëtar dedikuar të afërmeve të tyre janë 76%. Burimet e të dhënave në anën e debitit janë buxheti i UNMIK-ut/EULEX-it, Ministria e Ekonomisë dhe Financave për Ndihmën Zyrtare për Zhvillim në Kosovë.

*Asistenca tjetër e donatorëve (ATD) për qeverinë.* Asistenca teknike është përkrahje e vazhdueshme e komunitetit ndërkombëtar për fuqizimin e aspektit institucional të Institucioneve të Kosovës, e cila kryesisht është zotuar dhe lëvruar përmes: investimeve kapitale, asistencës teknike, furnizimit të pajisjeve, kreditimit (investimit në infrastrukturë), trajnimit dhe të tjera. Të dhënat në BP janë krijuar duke u bazuar në raportin e hartuar nga Qendra Koordinuese e Donatorëve. Supozimet dhe vlerësimet përkitazi me transaksionet e ATD-së dhe stafit janë të ngjashme si në rastin e UNMIK-ut.

## LLOGARIA KAPITALE

Në kuadër të *llogarisë kapitale* janë të përfshira investimet në ndërtim të bëra nga KFOR-i dhe transfertat e emigrantëve. Burimet kyçe të informacionit për transfertat e emigrantëve janë të dhënat nga KFOR-i dhe SRTN-ja.

## LLOGARIA FINANCIARE

Përfshinë transaksionet në mjetet e huaja financiare (kërkesat ndaj jorezidentëve) dhe detyrimet e huaja financiare (detyrimet ndaj jorezidentëve). Të katër kategoritë (investimi direkt, investimi portofolio, investimet tjera dhe mjetet rezerve), bazohen kryesisht në marrëdhënien në mes të palëve, dhe së dyti mbi natyrën e instrumentit të përfshirë.

1. **Investimet Direkte** janë kategori e investimeve ndërkombëtare që, bazuar në pronësinë e të paktën 10% të ekuitetit, reflekton interesin e përhershëm nga rezidenti në një ekonomi (investuesi direkt) në ndërmarrjen rezidente në një ekonomi tjetër (ndërmarrja investuese direkte). Duke përdorur këtë kriter, marrëdhënia direkte e investimit mund të ekzistojë në mesin e një numri të ndërmarrjeve të bashkuara, pavarësisht nëse lidhja përfshin një varg zingjiror të vetëm apo një numër të vargjeve zingjirore. Komponentët e transaksioneve të investimit direkt janë:
